LIGJ
Nr. 14/2019

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL PËR SHQIPËRINË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 66/2017

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më 5.3.2019

Shpallur me dekretin nr. 11144, datë 11.3.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE NDRYSHUESE

E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL PËR SHQIPËRINË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 66/2017

Për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, faza 3, 2017-2019

Kjo marrëveshje ndryshuese lidhet ndërmjet:

1.KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËSSËSHQIPËRISË,TË PËRFAQËSUAR NGA ZËVENDËSKRYEMI-NISTRI; DHE

2. FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, NË ROLIN E AGJENCISË BASHKË-PUNUESE; DHE

3. QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA AGJE-NCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM

MEQË Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, kanë lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit teknik për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, në datën 31 mars 2017 dhe ratifikuar me ligjin nr. 66/2017 ("Marrëveshja fillestare e bashkëpunimit teknik"), në vijim të së cilës zbatohet projekti "Programi për zhvillimin rajonal për Shqipërinë", faza 3, financuar nga granti i vënë në dispozicion prej SDC-së dhe ADA-s, në shumën 3'445'000 CHF;

SI DHE bazuar në korrespondencën me nr. 7F-07021-3, të datës 3 korrik 2018, dërguar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, e cila shpreh kërkesën për zgjatjen e afatit të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, si dhe përcaktimin e homologut dhe pikës së kontaktit të projektit PZHR3 që do të marrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në marrëveshje, duke qenë se Ministria e Zhvillimit Urban, e cila ka nënshkruar marrëveshjen duke përfaqësuar qeverinë shqiptare, nuk është më pjesë e strukturës aktuale qeverisëse.

BAZUAR NË SA MË SIPËR, palët kanë rënë dakord të ndryshojnë pjesët e mëposhtme të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik, si më poshtë:

Neni 1

1. Shkronja "d" e nenit I të marrëveshjes do të ndryshohet në: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga Zëvendëskryeministri."

2. Pas shkronjës "d", të nenit 1 shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje:

"dh) Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë në rolin e agjencisë bashkëpunuese të projektit.".

Neni 2

Pika 1 e nenit II të marrëveshjes do të ndryshohet në: "Zëvendëskryeministri dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë agjenci bashkëpunuese të projektit.".

Neni 3

Afati i përcaktuar në pikën 1 të nenit IV të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik për përfundimin e fazës 3 të programit shtyhet deri në datën 31.3.2019.

Neni 4

Në nenin VI të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik do të shtohet paragrafi, në vijim:

"Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të vërë në dispozicion alokimet e nevojshme buxhetore për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) për projektin, përkatësisht në vlerën e mbetur nga diferenca e totalit të TVSH-së me vlerën e disbursuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të ndryshimit të marrëveshjes."

Neni 5

1. Fjalia e parë e nenit VII të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik do të ndryshohet, si më poshtë:

"Projekti është një ndërmarrje e përbashkët ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Zëvendëskryeministrit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, SDC-së dhe ADA-s përmes Ambasadës Zvicerane."

2. Paragrafi i tretë i nenit VII të marrëveshjes, që përcakton përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, do të ndryshohet, si më poshtë:

"Nga ana e Zëvendëskryeministrit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit:

i) Zëvendëskryeministri është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve për arritjen e objektivit 1 të projektit, përcaktuar në nenin II, pika 2/"a", të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik, dhe pranimin e produkteve të arritura përmes këtij objektivi;

ii) Fondi Shqiptar i Zhvillimit është bashkëpërgjegjës për koordinimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave 2 dhe 3 të projektit, përcaktuar në nenin II, pikat 2/"b" dhe 2/"c", të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik dhe pranimin e produkteve të arritura përmes këtij objektivi.".

iii) Zëvendëskryeministri dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si agjenci bashkëpunuese e projektit, ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve për të cilat është rënë dakord për projektin;

iv) Ofrojnë kapacitetet për të ndihmuar partnerin zbatues për pjesë të ndryshme të projektit;

v) Ofrojnë qasje ndaj informacionit përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore që mendohet se janë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e projektit. Çdo përdorim tjetër do t'i nënshtrohet lejes me shkrim të dhënë paraprakisht nga Kryeministria dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.".

Neni 6

1. Pika 2/"a" e nenit VIII të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik do të ndryshojë në: "Zëvendëskryeministri (bashkëkryetar i ICDP-së)".

2. Pika 2/"d" e nenit VIII të marrëveshjes do të ndryshojë në: "1 përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (drejtori)".

3. Pika 2/"e" e nenit VIII të marrëveshjes shfuqizohet.

4. Pika 5/"a" e nenit VIII të marrëveshjes do të ndryshojë në: "1 përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit".

Neni 7

Afati i përcaktuar në nenin XVII të marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit teknik për periudhën që mbulon marrëveshja do të shtyhet deri në datën 31.3.2019.

Neni 8

Marrëveshja ndryshuese mbulon periudhën prej 30 shtatorit 2018 deri më 31 mars 2019.

Ajo do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kjo Marrëveshje është hartuar në tre (3) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Tiranë më 20.2.2019.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Z. Erion Braçe
Zëvendëskryeministër

PËR FONDIN SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT
Z. Dritan Agolli
Drejtor Ekzekutiv

PËR QEVERINË
E KONFEDERATËS ZVICERANE
Z. Adrian Maître
Ambasador